MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Silikonfarbe Stark Aussen: Ngjyrë emulsioni akrilike me rrëshirë silikoni me kualitet më të lartë për përdorim në sipërfaqe të jashtme.

- Zgjidhje shumë e mirë për vendet me klimë të lagësht dhe kushte të vështira atmosferike
- Kombinon rezistencën ndaj ujit me depërtueshmërinë e lartë të avullit të ujit
- Fuqi të shkëlqyeshme mbuluese
- Bardhësi të lartë
- Nuanca me stabilitet të gjatë të ngjyrës
- Pamje të rrafshtë mat
- Veti tejet të mira rrjedhjeje dhe për punë
- Ngjitje të fortë

SILIKONFARBE STARK
aussen

Përdorime të rekomanduara

MARMOFIX Silikonfarbe Stark Aussen është ngjyrë e dedikuar për dekorimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të jashtme të llaçeve çimento gëlqerore, betonit, çimentos me fibra. Duke qenë e bazuar në rrëshirë silikoni me kualitet të lartë dhe kopolimer akrilik, jep rezistencë të lartë ndaj ndikimeve atmosferike dhe dritës së diellit, duke siguruar mbrojtje të jashtëzakonshme për sipërfaqet e jashtme. Veçanërisht rekomandohet për restaurimin e ndërtesave historike dhe tradicionale.

...GARANTIERTE
QUALITÄT!

www.marmofix.ch

Marmofix DOOEL Chelopek, Brvenica
Address: 101 Str, No. 3, Chelopek, 1216
Tetovo, R. North Macedonia
Tel: +389 75 211 222

MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike
SILIKONFARBE STARK Aussen

Karakteristika teknike

Rrëshira	Rrëshirë silikoni dhe kopolimer akrilik
Dendësia(bardhë)	1,50±0,05 gr/ml
Viskoziteti pas prodhimit (bardhë) **Viskoziteti gjatë ruajtjes (bardhë)**	110±5 KU 23°C 110±5 KU 23°C
Harxhimi	Varësisht nga absorbimi dhe tekstura e sipërfaqes harxhimi mesatar për dy shtresa është: 0.30–0.35 kg/m^2
Tharja (bardhë) **Koha për riaplikim (bardhë)** **Tharja (nuancat)** **Koha për riaplikim (nuancat)**	45±10 Minuta 1±½ Orë 60±10 Minuta 2±½ Orë (Koha e tharjes dhe riaplikimit mund të zgjasë më tepër në temperatura të ulëta dhe lagështi të lartë relative.)
Nuancat	E disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe qindra nuanca tjera bazuar në SISTEMIN E NGJYROSJES MARMOFIX (MARMOFIXTINTING SYSTEM (MTS)
VOC (Komponime të avullueshme organike)	Vlera kufitare për këtë produkt i kategorisë A/c "mure të jashtme të substrateve minerale": 40g/l (2010). Produkti përmban max. 39g/l.

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

- **Përgaditja e substratit**

  Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe të ngjitur dobët për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Sipërfaqet e reja duhet të impregnohen me **TIEFGRUND TG-130 PRIMER,** të holluar deri 50% me ujë.

  Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.

  Përgaditja dhe aplikimi

  Metoda e aplikimit: Furçë, rul, spërkatje pa ajër

  Hollues: Ujë

  Hollimi: 10-20% v/v

  MARMOFIX Silikonfarbe Stark Aussen zakonisht aplikohet në dy shtresa.

  Në sipërfaqe të vazhdueshme të murit duhet të aplikohet pa ndërprerje, për tu shmangur sipërfaqeve të ngjyrosura në mënyrë të pabarabartë, tharje jo të njëtrajtshme etj.

  Aplikimi nuk duhet të bëhet në temperatura më të ulëta se +5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të gjitha aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Mjetet duhet të pastrohen me ujë menjëher pas përdorimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me **Silikonfarbe Stark Aussen**. Kur produkti aplikohet me spërkatje, përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore. Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake. **Silikonfarbe Stark Aussen** duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, **Silikonfarbe Stark Aussen** mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kova 20 kg